



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. do Prot

Tiranë, më 08, 02, 2013

**VENDIM Nr. 246, datë 08.02.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik për Projektin: Ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan, Loti 3", paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazheve arkeologjike, të kryer në segmentin rrugor Tiranë – Elbasan, Loti 3, KM 26+450 - 26 + 500, pranë fshatit Reçan, Elbasan, sipas traktit EL-T.26 të përcaktuar gjatë vëzhgimit intensiv arkeologjik në terren të gjurmës së rrugës, bazuar në Vendimin Nr. 197, dt. 04.06.2012 të KKA.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë zbatimit të projektit nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Tiranë.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori (Autoriteti Rrugor Shqiptar) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Tiranë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171

Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)